



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**Prishtinë, 27 nëntor 2019**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_1201\_2019**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtrishme të Energjisë;
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve,dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum nga panelet solare/fotovoltaike, e vendosur në objektin shtëpi banimi me kapacitet të instaluar prej 2 kW në fshatin Pagarushë, Komuna e Malishevës, të datës 11.11.2019 me nr. prot. 593/2019 të aplikuesit Nexhat Kryeziu, me adresë: fshati "Pagarushë" Komuna e Malishevës, Republika e Kosovës,

**në seancën e mbajtur më 27 nëntor 2019 nxori këtë:**

## **V E N D I M**

### **PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM**

- I. **APROVOHET**- kërkesa e aplikuesit Nexhat Kryeziu për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin shtëpi banimi, fshati Pagarushë, me kapacitet të instaluar prej 2 kW, që do të vendosen mbi objekt të banimit në Komunën e Malishevës.
- II. **OBLIGOHET** – aplikuesi Nexhat Kryeziu me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DGJ- 9044697 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtroj kërkesë në KEDS SH.A., për pranim teknik të objektit energjetik.
- III. ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV. Aplikuesi Nexhat Kryeziu do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.

## **Arsyetim**




- ZRRE, me datë 11.11.2019 nga aplikuesi Nexhat Kryeziu ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin shtëpi banimi, fshati Pagarushë, me kapacitet të instaluar prej 2 kW, që do të vendoset mbi objektin e banimit, shifra e konsumatorit DGJ- 90446979, në Komunën e Malishevës.
- Aplikuesi, s'bashku me aplikacioni ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetorë të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergjetik Nr. 6951 të datës 11.10.2019 të lëshuar nga KEDS SH.A., projektin teknik dhe pëlqimin Nr. 05/513 të datës 07.11.2019 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm e Komunës së Malishevës.
- Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit Nexhat Kryeziu dhe dëshmime të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike që do të vendoset mbi objektin e banimit në fshatin Pagarushë, me kapacitet të instaluar prej 2 kW shifra e konsumatorit DGJ- 90446979, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

  
Arsim Janova, p.d. kryesues

  
Besim Sejfiqaj, anëtar

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,
- Komunës së Malishevës,
- KEDS SH.A.,dhe
- Arkivit të ZRRE-së.